



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

QENDRA KOMBËTARE E KULTURËS PËR FËMIJË

Nr. _____ prot

Tiranë, më ____/____/2020

Relacion Monitorimin 12-mujori 2019

Qendra Kombëtare e Kulturore për Fëmijë ka për qëllimin edukimin dhe argëtimin e fëmijëve, kultivimin e prirjeve, talenteve, formimin e shprehive dhe shkathtësive. QKKF shërben për njohjen, ruajtjen dhe forcimin e traditës kombëtare, edukon atdhedashurinë, si dhe ndihmon për njohjen e vlerave të kulturës botërore.

Në shërbim të edukimit dhe argëtimit, zhvillimit të lirë të mendimit dhe krijimit, talentit dhe aftësisë, QKKF organizon veprimtari shkollore e ndërshkollore, kombëtare dhe ndërkombëtare si: konkurse, olimpiada, festivale, ekspozita, ekskursionë, promovime librash, takime me shkrimtarë, kompozitorë, piktorë, aktorë, etj.

Gjatë vitit 2019 QKKF, TK, ka realizuar 321 shfaqje në total me 44,041 spektator/audiencë dhe ka realizuar 13 projekte dhe aktivitete artistike së bashku me qendrën e fëmijëve.

Rreth 1964 fëmijë janë aktivizuar në aktivitete kulturore të zhvilluara nga QKKF ku janë përfshirë jo vetëm fëmijët që ndjekin kurset artistike por dhe fëmijët e shkollave të kryqytetit dhe fëmijët në nevojë.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 janë realizuar 13 projekte dhe aktivitetet artistike nga 9 të parashikuara deri në fund të vitit ose 133.33 %. Aktivitetet dhe Projekte e realizuar janë:

- 1) Dita Nderkombetare e Librit;
- 2) Festivali i kercimit për Femije;
- 3) Shfaqja teatrale Rosaku i Shëmtuar,
- 4) Shfaqja teatrale, Vallja e Pinguinëve;
- 5) Festivali Nderkombetar i Kukullave;
- 6) Turi Veror "Erdhi Teatri",
- 7) Ekspozita trashëgimi kulturore,
- 8) Shfaqja teatrale Kësulkuqja dhe Ujku Grykës,
- 9) Festa e 1 Qeshorit,
- 10) Pjesëmarje në Festivalin Nderkombëtar të Kukllave Lviv Ukrainë,
- 11) Aladini,
- 12) Ngjyrat e nëntorit,
- 13) Klipi i vitit të ri.

Nga fondet buxhetore të planifikuara për periudhën Janar-Dhjetor 2019 në shumën 41,691 milion lekë janë shpenzuar 40,081 milion lekë ose 96.12 % e tyre.

Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore është realizuar 98.15% për arsye se QKKF nga 30 punonjës që ka në organikë gjatë 6-mujorit të II-të të vitit 2019 ka patur 28 punonjës. Në sektorin

e financës pozicioni i specialistit ka qënë vakant për 9 muaj dhe gjithë ngarkesa e punës është përballuar nga përgjegjësja e sektorit të financës e cila krahas detyrave të saj funksionale ka kryer edhe detyrën e specialistit të financës, burimeve njërezore dhe mbajtjen e protokollit dhe vulën e institucionit.

Nga të ardhurat e realizuara jashtë limitit (nga sponsorizimet) në total 1,985,000 lekë nga të cilat 185,000 lekë nga Ambasada Italiane në vitin 2018 dhe 1.8 milion lekë nga Banka Raiffesen në vitin 2019, janë shpenzuar të gjitha për llogarinë 604/6 për mbulimin e shpenzimeve si marrjen me qira të hoteleve për akomodimin e pjesëmarrësve në Festivalin Nderkombetar të Kukullave nga data 3-9 Maj 2019 dhe për projektet artistike “Ngjyrat e nëntorit” dhe “Klipin e vitit të ri”.

Sqarojmë se fondet në llog 604/1 në shumën 1,100,000 lekë nuk u shpenzuan pavarësisht se kishim projekte të aprovuara në bordin artistik si "Qullaci i Hekurt " .

Ky projekt nisur nga rekomandimi i qeverisë për të pezulluar lidhjen e kontratave të reja për shkak të situatës emergjente të krijuar nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019, u anulua dhe po realizohet me buxhetin e vitit 2020.

DREJTOR I KOMANDUAR

FATJON SULSTAROVA